



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. 5691 prot.

Ballsh më, 14 . 11 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 43 Datë 14 . 11 .2025

PËR

**MIRATIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR
NXËNËSIT PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026**

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër nr. 66, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027”, të kërkesës nr. 4217 prot., datë 11.09.2025 të Pleqësisë së fshatit Aranitas, si dhe konstatimet e kryera mbi vështirësitë e lëvizjes në akset rrugore të mëposhtme dhe për të garantuar mundësimin që fëmijët/nxënësit e këtyre shkollave të zhvillojnë një proces normal mësimor,

PROPOZOJ:

1. Kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën 100 (njëqind) lekë / nxënës për çdo ditë për vitin shkollor 2025-2026, në linjat e mëposhtme:
 - Selitë - Shkolla 9 – Vjeçare Fratar
 - Çërrilë – Shkolla 9 – Vjeçare Gjerbës
 - Rripan - Shkolla 9 – Vjeçare Ngraçan
 - Ngraçie - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë
 - Belishovë - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë
 - Gadurovë - Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh
 - Ramaj – Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh
 - Muçaj, Bozhaj- Shkolla 9-Vjeçare Aranitas

- Në kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën e sipërcituar përfshihen dhe nxënësit me AK të cilët nuk e zhvillojnë procesin mësimor pranë vendbanimit të tyre (edhe në linjat të cilat nuk janë parashikuar më sipër).
2. Shpenzimet do të mbulohen nga nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, artikulli 602.
3. Efektet financiare fillojnë nga data 08.09.2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”